

Editorial

Data: 19 shkurt 2021

Vendi: Mitrovicë, "Va-Piano" Restaurant

Ora: 10:30

Me 19 shkurt, në Mitrovicë, u organizua një bashkëbisedim mes të rinjëve dhe Z. Fitim Ramës, përfaqësues i administratës publike në Komunën e Mitrovicës, me temën "Angazhimi i të rinjëve në drejtësi dhe në vendimmarrje në nivelin Komunal". Ky bashkëbisedim u organizua nga CBM përmes projektit "Rritja e qasjes në drejtësi në nivel komunal", në bashkëpunim me YIHR-KS, mbështetur nga Departamenti i Shtetit Amerikan.

Bashkëbisedimi nisi me prezantim të projektit dhe pjesëmarrësve, dhe pastaj vazhdoi me z. Fitim Rama, kordinator i Njesisë për të Drejtat e Njeriut në Komunën e Mitrovicës, i cili u fut në temë përmes ciklit të procesit të politikbërjes, ku tregoi se si bëhet vlerësimi, riformulimi, përgatitja e agjendës, hartimi, nxjerrja e vendimeve, zbatimi dhe monitorimi.

Pastaj në fokus ishin mekanizmat që mundësojnë përfshirjen e të rinjëve në procesin e politikbërjes në kuadër të Komunës së Mitrovicës. Aty u përmend ligji për qeverisjen lokale i cili i mundëson qytetarëve të bëhen pjesë e proceseve në komunën e tyre. Nga mekanizmat ekzistues të pjesëmarrjes qytetare në vendimmarrje, z. Rama i veçoi tre nga ta: informimi, apo mënyra e informimit të qytetarëve nga ana e Komunës, pastaj kërkesat për qasje në dokumente publike, konsultimi publik siç janë takimet publike dhe takimet të tjera, por nuk la pa përmendur edhe mekanizmat tjerë si: peticioni, iniciativat, referendumi. Përgjatë debatit, z. Rama foli edhe për komitetet konsultative, të cilat funksionojnë në kuadër të Komunës së Mitrovicës, ku pjesëmarrës në këto komitete janë edhe përfaqësues nga shoqëria civile. Pjesëmarrësit shfaqen interesim të lartë rreth proceseve të vendimmarrjes dhe procedurave për përfshirjen e tyre në këto procese.

Bashkëbisedimi u përbyll me rekomandime nga z. Rama, i cili i inkurajoi të rinjtë të bëhen pjesë e vendimmarrjes në nivel komune, duke sqaruar se si ata mund të marrin pjesë dhe të monitorojnë seancat e Kuvendit Komunal.

Nerimane Ferizi
Moderatore

"Ky editorial është mundësuar me mbështetjen e YIHR KS dhe financuar nga Departamenti i Shtetit Amerikan (INL). Përmbajtja e këtij editoriali është përgjegjësi e plotë e CBM dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e INL apo YIHR KS"